



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.02.2016 (e Hënë)** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**. Konstatohet se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes, në mbledhje të kuvendit kanë janë të pranishëm 29 Kuvendarë, 2 mungojnë.

Kryesuesi Elshani – Fillimisht më lejoni të përshëndes Kryetarin e komunës z. Idriz Vehapi, nënkryetarin z. Xhemali Haxhimustafa me bordin e drejtorëve, përfaqësuesit e OSBE-së, monitoruesin e KDI-së, Monitoruesit e KFORIT, përfaqësuesit e mediave, një përshëndetje e veçantë shkon për nxënësit e shkollës së mesme “Ukshin Hoti” në Krushë të Madhe të cilët sot i kemi këtu prezent, juve delegat të nderuar dhe gjithë të pranishmit e tjerë. Besoj se rendin e ditës e keni marrë me kohë, Nëse ka ndonjë prej delegatëve të nderuar që ta arsyetojë mungesën në mbledhjen e kaluar?

Rend Dite

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit financiar për realizimin e Buxhetit komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2015,
3. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ngritjen e shtatores së Heroit të Kosovës “Shejh Mihidinit”,
4. Shqyrtimi i Kërkesës së NTP “Vëllezërit Morina” nga Xërxa për dhënien e lejes së përkohshme për ushtrim të veprimtarisë,
5. Shqyrtimi i propozim vendimeve për mbrojtjen e vlerave të natyrës (10 vendime),
6. Shqyrtimi i kërkesës së N:T:H: “Mowenpick” nga Rahoveci,
7. Shqyrtimi i kërkesave të klubeve sportive për ndihmë financiare,
8. Rishqyrtimi i vendimit 130.01 të dt. 09.12.2015 i Kedsit,
9. Propozim vendimi për kompensimin e dëmeve të Nikë Martin Uka nga fshati Doblibare – Gjakovë,
10. Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e Këshilltarëve.

Kryesuesi – Informoj Kuvendarët e Komunës lidhur me ndryshimet që janë bërë në Ekzekutivin e komunës. Kemi dy pika shtesë për mbledhjen e sotit, njëra pikë është një vendim të cilin e kemi marrë në muajin dhjetor lidhur me Kedsin, ky vendim është kthyer nga MAPL-ja sipas tyre ky vendim nuk është në harmoni me ligjet mbi ndërtimet. Besoj se zyra ligjore brenda 4-5 ditëve do ta harmonizojë këtë vendim dhe pastaj do ja dërgojmë prapë MAPL-së për verifikim të ligjshmërisë, besoj se këtu nuk kemi çka të debatojmë por vetëm duhet ta kalojmë prapë përmes Kuvendit. Si pikë të dytë e kemi një propozim vendim me të cilin propozohet që z. Nikë Martin Uka nga fshati Doblibare i komunës së Gjakovës ti kompensohet për dëmtimin e pronës së tij të paluajtshme e cila gjendet në ngastrën kadastrale e cila është e evidentuar në certifikatën e lëshuar nga komuna e Gjakovës, vendi quhet Lugu i Butë me kulturë Mal Klasa e 3 me një sipërfaqe më shumë se 2 hektarë. Ky person kërkon kompensim për shkak se ju ka dëmtuar prona gjatë vendosjes së gypit të ujësjellësit gjatë vendosjes së 5 fshatrave të komunës së Rahovecit.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë, kemi të bëjmë me një lëndë e cila është që nga viti 2012, shtrirja e gypit kryesor nga fabrika e përpunimit të ujërave ka kaluar nëpër një pronë private dhe dëmi i cili është shkaktuar kësaj prone nuk është kompensuar. Më vonë është formuar një komision i cili e ka bërë vlerësimin e dëmeve ku është prurë në komunë një procesverbal por nuk është vepruar më tutje. Kemi reagime nga pronari i kësaj parcele se nëse nuk i bëhet kompensimi do të merë masa tjera ndaj komunës lidhur me këtë çështje. Prandaj kishte me qenë mirë nëse pajtoheni edhe ju që ne sot ta qesim si pikë e rendit të ditës dhe ta kryejmë këtë procedurë si e kërkon edhe ligji.

Kadri Dellova – Një takim që kemi pas me nxënësa dhe student ata kanë bërë një kërkesë për lirim të biletave për relacionin Rahovec – Gjakovë dhe fshatrave, a kishte qenë mirë që edhe ne si kuvendë me diskutu rreth kësaj çështje.

Kryesuesi – kam pas edhe shumë kërkesa të tjera por sot unë nuk i kam futur si pikë e rendit të ditës. Kërkesa në fjalë besoj se nuk ka nevojë të futet si pikë e rendi të ditës në kuvend por përmes drejtorisë besoj se do ju kthejmë një përgjigje, po ashtu kjo është çështje e kompanive të transportit publik dhe ne si kuvend nuk mundemi të i detyrojmë as që të ulin çmimin por as që ta ngrisin çmimin.

E qesë rendin e ditës në aprovim me këto dy pika shpesh? Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Hysni Gashi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, për hir të korrektësisë në mbledhjen e ka qenë mysafirë drejtori i policisë së regjionit të Gjakovës, në procesverbal është shkruar emri tij Muhamet Hasi ndërsa emri i tij është Ahmet Hasi, vetëm kjo duhet të përmisohet.

Flori Boshnjaku – Përshëndes të gjithë të pranishmit, çdo herë në fillim të mbledhjes ju si kryesues duhet të cekni a ka kuorum në sallë për mbajtjen e mbledhjes dhe sa anëtar janë prezent patjetër kjo duhet të ceket në procesverbal, deri më tani asnjë herr nuk është cekur. Po ashtu tek diskutimi imë unë kam pyetur për të hyrat e jashtëzakonshme e jo për të hyrat e rregullta. Po ashtu në funde asnjëherë nuk shkruan se kush është procesmbajtës, është mirë të ceket se kush e ka kryesuar mbledhjen dhe kush është procesmbajtës.

Kryesuesi – Faleminderit Flori kanë qenë vërejtjet me vend dhe ne do ti marrim parasysh këto vërejtje.

Rukije Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, tek faqja ime lidhur me pyetjen që i kam paraqitur komandantit të policisë ka qenë pyetja sa po mirën masat ndaj personave të cilat po i shkatërrojnë pyjet tona e jo siç është cekur në procesverbal duke i shkaktuar, besoj se është gabim teknik.

Kryesuesi - E qesë në aprovim Procesverbalin: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali me vërejtjet që u dhanë nga kuvendarët. Kalojmë në pikën e dytë.

2. Shqyrtimi i Raportit financiar për realizimin e Buxhetit komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2015,

Ky raporte financiar ka kaluar në KPF ka pas disa vërejtje, konsideroj se ky raporte është mjaft analitik dhe gjithë përfshirës

Lulzim Sylejmani - Prezantoj raportin financiar Janar – Dhjetor 2015 të komunës së Rahovecit. Drejtori sqarohet ne detaje të gjitha të arriturat e këtij raporti si dhe shkaqet e mos realizimit të planifikimit buxhetor për vitin 2015.

Selim Duraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, falënderoj drejtorin për raportin e detajuar. Do të ndalem tek faqja nr. 8 kodi 50503 inspektimi i respektimit të planit urbanistik, në vitin 2014 kemi pas të hyre 27,739.86 € ndërsa në 2015 vetëm 990.00 €, kërkoj një sqarim, pastaj nëse ndalemi tek planifikimi dhe realizimi i të hyrave unë kisha me thanë se është bërë një keq planifikim, tek administrata ku kemi taksat e pjesëmarrjes në tender , administrata ka planifikuar 5.000 € ndërsa janë realizuar vetëm 50 €, ku ka pas ngecje këtu. Pastaj tek drejtoria e urbanizimit kemi taksat komunale për leje ndërtimi planifikimi ka qenë 40.000 € ndërsa janë realizuar vetëm 15,142,41 €. Tek respektimi i planit urbanistik të planifikuar kanë qenë 30.000 € janë realizuar vetëm 990.00 €. Tek drejtoria e Ekonomisë, qiraja në objektet publike kanë qenë të planifikuar 100,000.00 € janë realizuar 51,169.89 €, ne në këtë kategori i kemi liru disa lokale ose biznese ku kanë pasur një afat prej 3 muajve që ti kryejnë të gjitha obligimet, e pyes drejtorin deri ku ka arritur kjo çështje dhe a janë bërë pagesat. Në faqen 15 tek raporti i shpenzimeve sipas programeve (Drejtorive) janar – Dhjetor 2015, tek zyra e kuvendit komunal ne edhe në KPF kemi kërkuar se ku i ka bërë shpenzimet në mallra dhe shërbime të kuvendit komunal, ka qenë 13,500.00 €, sipas drejtorit janë paguar komisionet me këto mjete por ne e dimë që asnjë komision nuk është paguar edhe për këtë dua një sqarim nga drejtori. Faqe 17 tek raporti i shpenzimeve për mallra dhe shërbime për vitin 2014/2015, tek shpenzimet e udhëtimit brenda vitit, për vitin 2014 nuk është paraqitur asnjë shpenzim kurse në vitin 2015 janë 16,538.45 €. Po ashtu tek kodi 14410 shpenzimet sipas te gjykatave edhe këtu në vitin 2014 nuk kemi asgjë të paraparë kurse për vitin 2015 kemi 20,612.75 €. Në faqe 33 kemi dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi ku janë ndarë 100,000.00 €, këtu shohim se është cekur se çmimi për një spërkatje është 22,875.00 € më duket ky çmim si shumë i lartë. Kërkoj nga drejtori për të gjitha këto pyetje e parashtruara një sqarim.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë, në faqe nr. 4 tek të hyrat vetanake mendoj se është një planifikim i gabuar nëse thuhet se janë planifikuar 1,099,014.04 € ndërsa të realizuara kemi 803,158.01 € dhe nëse arsyetim është vendimi për falje të borxhit, po si është e mundur kur jemi duke parë se të hyrat vetanake janë rritur çdo muaj. Flitet për një vlerë prej 295,000.00 € ku në përqindje i bie 26 % e buxhetit të të hyrave vetanake, nëse ja shtojmë kësaj vlerë edhe 640,000.00 € të buxhetit i cili nuk është votuar nga Kuvendi Komunal i bie që 935,000.00 € janë parat e humbura dhe me këto para mendoj që shumica e projekteve ishin realizuar.

Flori Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë, në këtë raporte e kemi diskutuar edhe në KPF por edhe sot i kam disa pyetje konkrete për drejtorin. Në faqe nr.9 tek të hyrat vetanake, në drejtori të arsimit i kemi 10,170.00 €, kur të kam pyetur në KPF se pse janë këto për ushqim dhe pije 17,926.50 € pra 4,000.00 € ma shumë se në vitin 20104. Në kodin 21 kemi 7,000.00 € ju jeni deklaruar se kanë shkuar për çerdhe, çerdhja si në vitin 2014 po ashtu në 2015 i ka të hyrat vetanake të njëjta, pra nëse nuk është shtuar numri i fëmijëve si kanë mundur të bëhen gjithë këto shpenzime. Dua një përgjigje ose nga ju ose nga Drejtoresha e Arsimit. Kryesuesi deklaroj se nxënësit dhe studentët kanë paraqitur një kërkesë për shpenzime të udhëtimit, në faqe nr. 17 tek shpenzimet e udhëtimit brenda vendit janë bërë 16,538,45 € kam kërkuar për këtë sqarim edhe në KPF, drejtori ka deklaruar se është duke i paguar shpenzimet e udhëtimit nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, pikërisht ka thënë nxënësve të Zatriqit unë nuk jam kundër unë jam që të gjithëve të ju paguhen, deklaroj se çdo muaj me kombin që udhëtojnë këta nxënës komuna paguan nga 18 € për një nxënës, pra dua ta di a paguajnë nxënësit rrugën vetë apo komuna ja paguan, nëse paguajnë ata vet atëherë pse drejtori thotë se komuna po i paguan udhëtimin. Në kodin 13460 tek shërbimet të kontraktuar tjera në vitin 2014 kemi pas 41,857.60 € ndërsa në vitin 2015 kemi 136,347.72 € dua ta di se sa punëtor janë punësuar me kontratë mbi vepër. Në faqen nr. 26 tek subvencionet kemi obligim për këtë vite 16,750.00 €, drejtori ka deklaruar që ju i keni pru vendimet dhe na keni shti në obligime, sot ne kemi kërkesën për subvencionim të klubeve sportive, ne tash mundemi të themi se do i japim nga 100.000 € klubeve dhe ta shtimë kryetarin e komunës në obligime, deri sa ne nuk kemi propozime nga drejtoria dhe ta dimë se sa kanë mundësi ata të i ndajnë.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë, raporti financiar 2015 në krahasim me raportet e tjera është më i kompletuar por jo edhe i përkryer sepse këtij raporti i mungon shpenzimi i buxhetit për komunal, pra ne nuk e dimë se sa ka shpenzuar komuna e Rahovecit për rrymë, ujë, telefon dhe për mbeturina, pra një informatë shumë me rëndësi mungon. Ajo që vazhdimisht i kam kërkuar drejtorit kësaj here e ka bërë pra të hyrave vetanake sipas drejtorive, por tabelat të cilat janë paraqitur në raporte janë të pa lexueshme sepse janë të një formati shumë të vogël. Të hyrat për vitin 2015 nuk janë aq të mëdha në krahasim me vitin e kaluar, kam pritur që tatimi në pronë të ketë një rritje më të madhe sepse duke mos marrë parasysh shlyerjen e borxheve por vetëm regjistrimin e objekteve të reja tatimi në pronë është dashur të jetë më i madh, me marrjen e vendimit mbi shlyerjen e borxheve kam pritur që tatimi në pronë të ketë të hyra më të mëdha por kjo nuk ka ndodhë. Më çudit fakti se si drejtori nuk e ka cekur një të dhënë që për ne delegatët është shumë me rëndësi, vendimi mbi shlyerjen e borxheve sa ka qenë në total. Tek pasqyrimi i të hyrave vetanake sipas drejtorive, ka një diferencë të vogël nëpër gjitha drejtoritë, por tek Drejtoria e Urbanizimit kanë ngecur të hyrat dhe i kisha propozuar drejtorit që të shikoj se ku kanë ngecur këto të hyra sepse ka një diferencë të madhe në planifikim dhe realizim. Tek realizimi i buxhetit nga investimet kapitale kemi pasur buxhet 2,728,624.92 € ndërsa janë realizuar 2,586,373.68 € pra ka një diferencë prej 142,251.00 € pra kjo shumë ka mbetur e pa shpenzuar dhe ka shkuar në suficit, kishte qenë edhe ma mirë sikurse drejtori ta kishte qitur edhe një shtyllë krahasim me raportet e tjera dhe ma pa mbetjet e mjeteve të lira për secilin kod dhe kategori. Dua ta di se pse ka shkuar kjo shumë në suficit ku ka mundur të kryhet ose të paguhet një projekt me këtë shumë. Analizimi i shpenzimeve në mënyrë analitike, tek mëditjet e udhëtimit mundë të ndodhë që një vite të kemi ma shumë vitin tjetër më pak, pra këto janë shpenzime që ne nuk mundemi ti diktojmë. Tek shpenzimet e telefonit kemi një rrënjë 8.000 € vitin 2014 ndërsa 6.000 € në 2015, e kam vërejtur në raporte se tek këto drejtori nuk ka fare shpenzime të telefonit për 2015 si Administrata e Përgjithshme, drejtoria e Shërbimeve Publike, në Bujqësi, Ekonomi dhe Zyra për Komunitete. Tek shpenzimet e karburanteve ka një rritje simbolike krahasuar me vitin 2014 por prapë e them se këto shpenzime ne nuk mundemi ti diktojmë sepse janë faktorët e tjerë, por tek shërbimet e kontraktuara tjera

drejtor janë harxhuar shumë pare 136,000.00 € mendoj se janë shumë. Tek shpenzimet ushqim, pije dhe dreka zyrtare kam bërë një analizë në këtë vite ka një rrënjë të vogël, vitin 2014 kanë qenë 32,000.00 € ndërsa në vitin 2015 29,000.00 €. Po ashtu ka një rrënjë të mirë tek riparimi i automjeteve dhe kjo më ka pëlqyer dhe uroj që edhe në të ardhmen të zvogëlohen edhe më shumë. Tek realizimi i projekteve, mua më intereson një projekt ndërtimi i rrugëve në fshatin Zoqishtë, Pastasel, Polluzhë, Dobidol dhe Guri i Kuq, kontrata u lidh me 09.2015 vlera e kontratës është 245,000.00 € dhe ky projekt ka mbetur i pa realizuar, pyetja ime është për drejtorin e Shërbimeve Publike pse ka mbetur ky projekt i pa realizuar, drejtori gjithmonë më ka premtuar se do të realizohet ky kryhet ky projekt. Në faqe nr. 35 vlera e borxheve të pa mbuluara është 1,371,373.22 € ndërsa për pagesë është 679,450.73 €, unë nuk e besoj mirëpo prapë do presim se çka do të thotë auditori i jashtëm për pasqyrat financiare për komunën tonë.

Azbi Gashi – Përshëndetje për të gjithë, fillimisht do të filloj me krahasimin e të hyrave në periudhën janar - Dhjetor 2014-2015. Tek gjobat e inspektoratit edhe në vitin 2014 po ashtu edhe në 2015 janë zero, mos vallë vendi ynë është aq në nivel dhe prandaj nuk kemi asnjë gjobë nga ana e inspektoratit. Pastaj licencat e pranimit teknik të lokaleve në vitin 2014 kanë qenë 1,995.50 € ndërsa në 2015 është zero. Pastaj qiraja nga objektet publike në 2014 ka qenë 2,483.90 € ndërsa në vitin 2015 është zero, pyes drejtorin pse ka ndodhë kjo. Faqe nr.17 raporti i krahasimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime për vitin 2014/2015 jam duke parë një vlerë të konsiderueshme për mobile në vitin 2014 kanë qenë 19,649.00 € ndërsa në 2015 kanë qenë 18,385.37 € a jemi duke blerë çdo vite mobile. Tek pajisjen më pak se 1.000€ në 2014 kemi pas 16,046.59 € ndërsa në 2015 kemi 14,403.88 €. Pastaj tek shpenzimet për veshmbathje në vitin 2014 kemi pas zero shpenzime ndërsa në vitin 2015 kemi 3,082.00 €, a është fjala për drejtorin e zjarrfikësve apo ndonjë drejtorie tjetër. Në faqe 19 kodi 14410 shpenzimet sipas gjykatave në vitin 2014 kemi zero ndërsa në vitin 2015 kemi 20,612.75 €. Tek asambleje jam duke parë për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve në 2014 ka qenë 524.00 € ndërsa në 2015 është 1,026.00 €, kemi bërë edhe më herët pyetje dhe duhet ta dimë a ka asambleja veturë. Tek zyrë për komunitete karburanti për vetura çdo vite është duke u rritur në vitin 2014 ka qenë 2,568.00 € ndërsa në vitin 2015 është 3,397.00 €. Sigurimi i automjeteve tek drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në vitin 2014 kemi 98.60 € ndërsa në vitin 2015 kemi 1,017.00 € pse ky dallim kaq i madh.

Rukije Krasniqi – Përshëndetje për të pranishmit, dua të ndalem rreth atyre ankesave që janë nga ana e Kryetarit që dy vite prej sa ka ardhur në detyrë si Kryetar i Komunës, po ashtu edhe drejtori i financave në çdo mbledhje të Kuvendit është ankuar për borxhe ndërsa sa pashë unë këtu kishim rreth 140,000.00 € në suficit, falë zotit që nuk keni pas më tepër mjete se kishin shkua ma të gjitha në suficit.

Kadri Dellova – Përshëndetje për të gjithë, dua të bëjë një sqarim për z. Florije rreth udhëtimit të nxënësve është e vërtetë se studentët dhe nxënësit kanë kërkuar ndihmë prej komunës për zbritjen e çmimit të biletave krahas rrënjës së çmimit të derivateve, dua ti marrë 3 shembuj: Pastasel – Rahovec distanca 7 km bilete 1 €, Rahovec – Gjakovë 3 €, Krushe e Madhe- Prizren 1.50 € besoj se komuna jonë dhe Drejtoritë përkatëse të cilat kanë bashkëpunim me këto kompani transportuese të bëjnë një marrëveshje për ti ofruar një ndihmë nxënësve. Po ashtu kishte me qenë mirë që komuna jonë në të ardhmen të ketë më shumë buxhet dhe të i paguaj udhëtimin nxënësve si të Zatriqit, kaznikut, Kramovikut dhe pjesës lindore. Ndërsa pyetjet e mija rreth raportit financiar janë këto: Së pari e vlerësoj punën e drejtorit i cili e ka bërë një raporte shumë të detajuar dhe analitik dhe kjo tregon që komuna e Rahovecit është shumë transparente, prandaj edhe raporti i fundit i cili ka dalë nga KDI-ja e ka radhitur komunën tonë si njëra nga komunat më transparente. Në faqe 34 në vitin 2015 dy biznese nuk kanë marrë asnjë mjetë prej borxhit të tyre krahas kontratave, këto dy biznese a nuk in kanë realizuar punimet që nuk kanë marrë asnjë mjet. Faqe 27 Rrethimi dhe rregullimi i oborreve të shkollave në komunën e Rahovecit, kontrata është 68,476.60 € të paguar janë 59,631.54 € ndërsa borxhi i mbetur për vitin 2016 është 1,059.96 €, më duket së është bërë një gabim teknik sepse sipas matematikës sime mbesin edhe 8,845.06 € apo ndoshta na ka falur kjo kompani këtë shumë, dua një sqarim nga drejtori.

Hysni Gashi – Përshëndetje për të gjithë, po ja filloj nga faqe 4 tek të hyrat vetanake, janë planifikuar 1,099,014.00 € ndërsa janë realizuar 803,158.04 € ku në përqindje i bije 73 %, drejtori e dha një arsyetim se ka ndikuar falje e borxheve, por mendimi imë është se falja e borxheve është dashur të ndikoj për stimulim për pagimin e tatimit dhe është dashur të ritet inkasimi i borxheve të reja, por edhe sikur të ishte ashtu në

raste kur paraqitet një pengës për realizimin e të hyrave duhet të gjinden format e tjera në mënyrë që ta balancojmë sepse përndryshe planifikimi nuk ka kuptim. Faqe nr.7 mendoj se është mirë që të bashkëpunohet më mirë me institucionet e drejtësisë dhe policisë, kuptoj se vendimi për mos konfiskimin e dokumenteve ka ndikuar në inkasimin më të vogël të gjobave, unë mendoj se ma shumë po i ndihmon kësaj neglizhenca e gjykatave se sa mos konfiskimi i dokumenteve. Faqe 8 tek krahasimi i të hyrave për periudhën janar – dhjetor 2014/2015 desha disa sqarime, ja m duke parë se tek gjobat e inspektoratit janë zero si për vitin 2014 ashtu edhe për vitin 2015, pastaj qiraja nga objektet publike në vitin 2014 2,483.90 € ndërsa në vitin 2015 kemi zero, kërkoj një sqarim për këtë. Pastaj tek inspektimi dhe respektimi i planit urbanistik në vitin 2014 kemi 27,739.86 € ndërsa në vitin 2015 kemi 990.00 € pra vetëm 3.57 € kërkoj sqarim se çka ka ndikuar tek kjo rrënjë. Tek raporti i krahasimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime 2014/2015 nuk jam duke kuptuar një pozicion shpenzime për veshmbathje në vitin 2014 nuk kemi pas shpenzime ndërsa në 2015 kemi 3,082.00 €.

Fatmir Iska – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket realizimit të hyrave së bashku me gjobat e gjykatave dhe të trafikut kemi në total 969,000.00 € ndërsa në raporte me planë kemi 129,731.00 € më pak realizim, shtrohet pyetja a ka ndikuar edhe ky ligj për falje të borxheve unë e them jo dhe kjo mundë të vërtetohet në tabelorin e faqe 13 që është tek tatimi në pronë, ku në muajin dhjetor kemi një rritje duke e marrë krahasimin me muajt paraprak, pra në këtë muaj kemi një inkasim shumë më të madh, mendoj se çështja është tek të hyrat e tjera prandaj e kemi këtë shumë prej 129,731.00 € më pak të hyra në raporte me planin. Faqe nr.17 tek raporti i krahasimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime për vitin 2014/2015 tek kodi 13460 shërbime e kontraktuara tjera në raporte me 2014 në 2015 kemi rreth 80,000.00 € më tepër, drejtori e ka cekur në KPF se është në pyetje kontrata me Caritasin, nëse kemi këtë rritje të kësaj shume, në 2014 në këtë kodë qenë mjete të njëjta ndërsa në 2015 kemi këtë rritje dua ta di ku janë marrë këto mjete kërkoj një sqarim nga drejtori. Tek karburanti për vetura kodi 13780 kemi rreth 20,000.00 € më pak shpenzime krahasuar me vitin 2014 kjo është për tu lavdëruar. Por prapë kur i kthehemi në total shpenzimet e vitit 2015 kemi një rritje krahasim me vitin 2014 diku afër 137,434.00 € më tepër shpenzime.

Luljeta Kadiri – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, nga raporti që e shfletova shihet një korrektësi e përshkrimeve të shpenzimeve dhe punëve të realizuara. Dua të ndalem tek Drejtoria e Shëndetësisë ku planifikimi për të hyrat ka qenë 40,000.00 € ndërsa janë realizuar 32,000.00 €, duke u bazuar në përvojën e punës është një përqindje e kënaqshme e realizuar, duke i ditur ballafaqimet dhe kundërshtimet e qytetareve për të participuar. Nga shpenzimet po të kësaj drejtorie në shpenzime për barna shohim diku 31 mijë e disa euro pra është duke u përputhur edhe me shumën e të hyrave. Kam një apel për të gjithë ne si pjesëmarrës të këtij kuvendi që të bëjmë fushat nëpër qytetar që ti vetëdisojmë për të participuar sepse ato të hyra janë për shpenzimet e tyre. Në faqe 25 është një shpenzim 4,540.84 € furnizim me ushqim dhe pije, dua një sqarim nga drejtori se ku janë shpenzuar këto mjete.

Kryetari Vehapi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, më vije shumë mirë që jeni duke i bërë një analizë detale raportit financiar të vitit 2015, unë duhet të jem ma shumë se ju i preokupuar dhe i shqetësuar se ku shkojnë mjetet e taksapaguesve, këtu kemi një auditor goxha të madh dhe është mirë që ti qartësojmë disa gjëra. Jemi pak të endikepuar me këto borxhe të trashëguara. Ne për vitin 2014 nuk kemi pas buxhet të miratuar, pastaj kemi pas një bartje të punëtorëve në një kompani menjëherë në vitin 2014, është dashur të gjendemi në mënyrë të ndryshme që ato punëtor të mos mbesin pa paga, planifikimi që është bërë nga ish qeveria për vitin 2014 nuk kemi mundur të kemi të gatshëm për shkak se kemi punuar me buxhet të vitit 2013 kjo ka qenë një pengës shumë e madhe. Ne kemi pas një deficit prej 624,000.00 € në buxhetin e vitit 2014. Në vitin 2015 kemi hyrë në kontratë për shërbime të varrimit aty është një shumë goxha e madhe që është dashur të mirët nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, pastaj tek subvencionet kemi pas borxhe si të bursave për studentë, po ashtu ne është dashur ti japim përparësi studentëve të rinj atyre që janë në drejtime deficitare dhe atyre me sukses të shkëlqyer. Kemi bërë disa pagesa për udhëtime të fëmijëve të cilat janë me nevoja të veçanta të cilat e ndjekin shkollimin special. Shuma më e madhe e cila është për kontratën që e kemi lidhë me Caritasin besoj se drejtori i financave dhe ai i shëndetësisë do ju jepe sqarime në detaje. Ne e kemi pas një numër të madh të teknikëve të punësuar me anë të Caritasit ata i kanë ndihmuar sadopak shëndetësinë në komunë por njëkohësisht e kanë ndihmuar edhe gjendjen ekonomike

familjare të tyre. Ne nuk kemi mundur ti mbajmë njerëzit dhe mos ti paguajmë, ju e dini të gjithë që njerëzit kanë punuar 6 muaj dhe nuk janë paguar për punën tyre. Pra të gjitha këto kanë ndikuar që borxhi të bartet nga viti në vit, por prapë ju kisha lutë të gjithë juve që të kërkonit çdo centë se ku ka shkuar. E lusë drejtorin dhe gjithë stafin që t[ë] jenë rigoroz në këto çështje në mënyrë që të dinë opinioni i komunës së Rahovecit se si shpenzohet paraja publike. Rukije kanë shkuar disa mjete në suficite këtë e di unë, por ta japë po ashtu edhe përgjigjen, ka qenë projekte i ri dhe aty ku nuk ka pranim teknik nuk paguhet asnjë centë, për me than se vetëm e realizuam buxhetin dhe nuk na ka shkuar asgjë në suficit dhe të paguajmë vende e pa vende unë këtë nuk e lejoj, ma mirë të kemi një raporte të saktë dhe komisioni të merë përgjegjësin që është pranuar puna ashtu si është në kontratë dhe në specifikacion dhe ne atëherë e bëjmë pagesën, aty ku nuk janë dokumentacionet e kompletuara nuk do të ketë pagesë. Kadri sa i përket punës së biletave, me e pas mundësinë të gjithë studenteve dhe nxënësve ja kisha bërë udhëtimin falës, ato janë kompanitë private dhe çmimin ja rregullon një rregullator, linjat edhe çmimet përcaktohen në nivelin qendror është një departament përkatës që mirët me këto çështje, ne si komunë mundemi vetëm të ju bashkohemi kësaj kërkesë dhe dëshiro që nxënësit dhe studentët tanë të kenë një lehtësim për të vijuar shkollimin e tyre.

Lulzim Sylejmani – Ju falënderoj për gjitha sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna në mënyrë që ne në raportet e ardhshme do të jemi më të qarta në informata. Do ja filloj me Selimin, sa i përket të hyrave vetanaka i cili është 1,099,014.00 € këtu përfshihet edhe planifikimi i gjobave dhe gjykatave, ndërsa tek realizimi 803,158.04 € është realizimi pa të hyrat nga gjobat dhe gjykatat. Sa i përket të hyrave në Drejtorin e Urbanizmit është një diferencë rreth 13.000 € krahasuar me vitin 2014, kjo është si pasojë e zvogëlimit të taksave për ndërtim ku rregullorja e re e ka taksën gati 50 % më të lirë se sa rregullorja e vjetër. Tek projekti i dezinfektimit që bëri pyetje Selimi kjo kontratë është 2 vjeçare. Tek raportin i shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve më së shumti u ceken për kontrata të shërbimeve të veçanta, po ju japë një përgjigje, kontrata për shërbime të veçanta në komunën e Rahovecit jashtë Caritasit për vitin 2015 kanë qenë rreth 22 kontrata dhe maksimalja e tyre ka qenë 2 - 4 muaj ndërsa pjesa tjetër është komplet e Caritasit. Ka pas shumë pyetje rreth shpenzimeve të udhëtimit brenda vendit, këto shpenzime janë shpenzime të nxënësve por nuk janë të gjitha për udhëtimin e nxënësve të shkollave të mesme por janë edhe për nxënësit e shkollave fillore janë kontratat të lidhura përmes zyrës së prokurimit. Po ashtu i kemi edhe disa vendime për udhëtimin e disa nxënësve si të shollës fillore ashtu edhe të mesme që janë me nevojë të veçanta. Ër këtë arsye këtë vit të shpenzim e kam ndarë nga shpenzime të udhëtimit

Zyrtar që të dihet më saktë se ku janë shpenzuar. Sa i përket shpenzimeve të mobileve që pyet Azbiu shumica prej tyre janë bërë nëpër shkolla për blerjen e ormanëve nëpër klasë, po ashtu një vlerë afër 5.000 € është për ambulanten re që e kemi ndërtuar në një lagje në Rahovec. Ka pas një pyetje rreth shpenzimeve të gjykatave, këtu e keni një pjesë shumë të vogël afër 2.000 € për shpenzimet e gjykatave ndërsa pjesa tjetër është ekzekutimet nga përmbaruesi privat për shpenzimet e pa paguara si të infopresit etj. Sa i përket suficitit që na ka mbetur nga buxheti Kryetari e dhe përgjigjen dhe nuk dua asgjë të shtoj rreth kësaj tema më shumë. Te obligimet e mbetura tek subvencionet aty janë tre fatura mujore për shpenzime të varrimit. Tek të hyrat nga çerdhja dhe shpenzimet e ushqimit, kodi shpenzim ushqim dhe pije nuk është i ndarë vetëm për çerdhe por është çdo shpenzim që bëhet nëpër administratë, por vlera që realizohet nga çerdhja gjithmonë shkon prapë në çerdhe për ushqim dhe pije. Sa i përket shpenzimeve komunale tek analitika e shpenzimeve i keni të gjitha shpenzimet se ku dhe cilën drejtori janë bërë, ndërsa pse në ndonjë drejtori nuk ka shpenzim të telefonit dhe në disa ka arsyeja është se fatura nuk Vjenë ndarës për secilën drejtori por vije kompletë dhe në një herë e qesim në një drejtori një herë në drejtorin tjetër pra kjo është arsyeja që disa drejtori në raporte nuk kanë fare shpenzim të telefonit. Tek shpenzimet e veshmbathjes janë dy parë dresa në inspektion që janë blerë vitin e kaluar. Sa i përket të hyrave nga inspektioni 99% të atyre të hyrave realizohen përmes gjykatës, pra nuk hynë si të hyra të drejtpërdrejta të inspektionit. Te të hyrat e tatimit në pronë Fatmir muajin fundit ka një rritje, që nga deklarimi i faljes ka ra në 13.000 € na ka përcjellë deri në muajin dhjetor sepse njerëzit ngurrofshin të vinë të pyesin sepse as ata nuk e kanë ditë se çka saktësisht është duke u falur ndërsa në muajin dhjetor kemi marrë një vendim që të gjithë ata që kanë pas vlera më të mëdha për pagesë ti vizitojmë, prandaj në muajin dhjetor ka pas të hyra nga 5.000 € - 6.000 € nga kompanitë më të mëdha. Tek të hyrat në shëndetësi pyeti Luljeta Kadiri, në këtë drejtori ka një rritje në

krahasim me vitin 2014 por mendoj se ka vende më shumë aty sepse kompletë ato të hyra prapë i kthehen shëndetësisë nuk shkojnë askund tjetër. Sa i përket lëvizjes së borxheve si sigurim, mirëmbajtje të automjeteve jeni duke e parë edhe në raporte se këto obligime janë duke u bartur nga viti në vit, po ashtu edhe pse kuvendi nuk ka një veturë të emëruar për kuvend nuk do të thotë se kryesuesi ose dikush nga kuvendi nuk ka përdorë ndonjë automjet tjetër të komunës. Tek çështja e qirasë Hysni shikoni analitiken tek drejtoritë dhe d të shihni se cili kod dhe në cilën drejtori është fjala. Sa i përket gjendjes së kontratave që ju kam prezantuar unë këto janë burime të cilat kanë ardhur nga zyra e prokurimit, këto nuk janë shifra që ne kemi ndërhyrë por janë nga një sistem i zyrës së prokurimit, ne vetëm i kemi ndarë në vite kontratat, po ashtu Kadri mundet të jetë ndonjë gabim por që nuk mundem të ju tregoj unë. Në fund sa i përket realizimit dhe shpenzimit të buxhetit unë me përgjegjësi e them se jemi në mesin e komunave më të mira sa i përket përqindjes së realizimit të buxhetit.

Afrim Limani – Drejtor konsideroj se nuk ma dhatë përgjigjen e saktë për suficitin prej 142,000.00 €. Do e përdorim një logjikë të thjeshtë: Projektet kapitale për vitin 2015 janë përafërsisht 25 dhe shuma mbetje pa pagesë është 1,300,000.00 € nuk e besoj se në mesin e 25 projekteve nuk ka ardhur ndonjë situacion për kryerje të pagesës. Pra kjo shumë nuk është në kuadër të një projekti por e disa projekteve. Pastaj tek shpenzimet e telefonit thatë se nuk ka shpenzime të mëdha, ndërsa unë mendoj se janë bërë koça do shpenzime të telefonisë fikse të cilat nuk janë prezantuar në raport. Është e palogjikshme që drejtorja e shërbimeve publike të i paguaj të gjitha shpenzimet e telefonisë ndërsa administrata jo. Po ashtu a e dini se sa është vlera e borxhit të tatimit në pronë që e ka falë Ministria me vendimin e marrë.

Lulzim Sylejmani – Po ja nisi nga fundi, raporti nga drejtorja për tatim në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave ende nuk ka ndonjë raporte që e saktëson se sa është falja e borxheve jo vetëm në komunën tonë por në asnjë komunë në Kosovë nuk e ka, arsyeja sipas tyre është se janë ende duke gjeneruar raportet e të hyrave. Sa i përket shpenzimeve të telefonit prapë e them që planifikimi tek komunalit është vetëm tek Drejtorja e Shërbimeve Publike po ashtu edhe të administratës janë në kuadër të atyre. Sa i përket subvencioneve ku shihet se kanë mbetur faturat e pa paguara ndërsa mjetet kanë shkuar në suficit, ne me asnjë kod buxhetor nuk kemi marrë ndonjë vendim se si ka qenë në të kaluarën nga ana e Kryetarit dhe drejtorëve që nga një kodë të paguajmë situacion në një kod tjetër që është i pranuar. Ne nuk e kemi paguar asnjë pagesë nga një kod në kodin tjetër, mundet të jetë rruga në Fortesë dhe tjetra në Drenoc, nëse ka pas mjete tek rruga në Drenoc dhe është pranuar situacioni e kemi paguar dhe nëse nuk ka pas ne nuk i kemi marrë ato mjete nga Fortesa dhe ti paguajmë në Drenoc, për këtë arsye kanë shkuar mjetet në suficit.

Kryetari – Artan e din se ligji ja lejon edhe Ministrit edhe Kryetari të Komunës një përqindje të buxhetit vetë me e bartë edhe pse ka pas kërkesa nuk kamë pas dëshirë me e bërë atë transferim.

Artan Zenuni – Atëherë po ju bëjë një pyetje Kryetar, tek shkolla e Optrushës tenderi i cili është dhënë në qershor ndërsa muajin nëntor prapë është shpallur tenderi për bazament, a ta ka prishë dikush tymin e duhanit aty apo çka është puna, po ashtu dua ta di se a ka pas keqpërdorime në këtë tender.

Kryetari – Në atë vend kur kanë shkuar ekspertët e gjeomekanikës kanë konstatuar se nuk është e mundur të ndërtohet objekti në këtë tokë të butë pa pilote, në projektin e parë nuk janë paraparë pilotët, prandaj jemi detyruar që për herë të dytë të bëjmë një shpallje tjetër me pilot në mënyrë që mos të rrënohet kjo shkollë sikurse që jemi duke e rrënuar tash sepse kjo shkollë është ndërtuar pas luftës por ne duhet tash ta rrënojmë që ta ndërtojmë tjetrën. Sa i përket asaj se a ma ka prish dikush tymin ju i keni dyert e hapura që të bëni gjitha ankesat aty ku duhet. Po ashtu ne nuk kemi lejuar që të marrin vendime drejtorët që të japin tokë të komunës në shfrytëzim me kohë të caktuar sikurse që ke dhanë ti kur ke qenë drejtor.

Kryesuesi – Falënderoj të gjithëve për kontributin e dhanë, konsideroj se të gjitha pyetjet e shtruar drejtorit i keni marr edhe përgjigjet nga ana e tij. Po ashtu konsideroj se raporti ka qenë mjaftë analitik dhe gjithëpërfshirës, kjo është situata të cilën e kemi në komunën tonë sa i përket të hyrave dhe shpenzimeve të bëra gjatë vitit 2015. E qesë në votim Raportin financiar 2015: Konstatoj se me 5 abstenime asnjë kundër dhe të tjerët pro është aprovuar raporti financiar për vitin 2015. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ngritjen e shtatores së Heroit të Kosovës “Shejh Mihidinit”,

Kujtim Popaj – Përshëndetje për të gjithë, është propozim i Kryetarit të Komunës dhe kërkohet nga ju që të shpallet interes i përgjithshëm ngritja e shtatores së heroit të Kosovës “Shejh Mihidinit”, vendi ku do të ngitet kjo shtatore është parcela me nr. 1196 me një sipërfaqe mjaft të madhe por ne kërkojmë vetëm 50m² për ngritjen e kësaj shtatore. Konkretisht ky vend gjendet përballë ish bankës Procredit afër qendrës së qytetit përgjatë rrugës “Xhelal Hajda – Toni”, parcela është pronë komunale dhe nuk ka kurrfarë kontesti kjo parcelë.

Florije Boshnjaku – Edhe në KPF e kam diskutuar këtë çështje, falënderoj Kryetarin që e ka marrë këtë vendim sepse me të vërtet heronjtë e Kosovës e meritojnë nga një shtatore: Në KPF kam propozuar që në kuadër të kësaj shtatore të mirët një vendim në Kuvend të Komunës që ti ngitet edhe nga një shtatore Mensur Zybarajt, Bedrush Gashit dhe Sejh Mihidinit, po ashtu propozoj sot këtu që ti ngritet edhe një shtatore Ukshin Hotit. Duhet të mirët një vendim se a do ti ndërtojmë këtë vite këto shtatore apo për sa vite të ardhshme do ti ndërtojmë këto shtatore. Në Kuvend jeni deklaruar se ende nuk keni vendosur se në cilin vend do ti vendosni shtatorët e Bedrush Gashit dhe Mensur Zybarajt. Po ashtu kam një pyetje ekzekutivi a është marrë pëlqimi i familjarëve për vendosjen e kësaj shtatore në këtë vend.

Kryetari – Ju e dini që në komunën tonë deri më tani janë të shpallur 5 heronj të Kosovës dy prej tyre i kanë shtatorët ndërsa 3 të tjerët jo, por ne kemi paraparë që këtyre 3 heronjve të Kosovës ti bëjmë nga një shtatore. Po ashtu e kemi në planë që ti ndërtojmë edhe 4 buste që do të vendosen nëpër shkolla. Pse nuk e kemi bërë me një vendim të tre shtatorët është se kemi mbet që të bisedojmë edhe me dy familjet e dy heronjve të tjerë ndërsa me familjen e Shejh Mihidinit kemi biseduar dhe janë pajtuar që në këtë lokacion që jemi duke propozuar të vendoset shtatorja. Plotësisht pajtohem me propozimin e Florijes për ngritjen e një shtatore për prof. Ukshin Hotin sepse ai e meriton, do të shikojmë që edhe për profesorin në të ardhmen me e gjatë një lokacion për me e vendos një shtatore. Mendimi imë është që Mensuri dhe Bedrushit ti kenë shtatorët në vendin e tyre të lindjes sepse të gjithë e dimë se aty ka qenë edhe një qendër ose bazë e UÇK-së, pikërisht në sheshin në mes të fshatit mirëpo në pamundësi për me biseduar me familjet e tyre kemi mbetur pa u dakorduar se ku të vendosen këto dy shtatore për këta dy heronj. Është mirë që ky propozim të kalojë sa më në heshtje sepse diskutimi i tepërt nuk na ndihmon asgjë.

Xhihad Vuçitërna – Fillimisht e përkrahi këtë iniciativë për vendosjen e shtatores së Heroit të Kosovës Shejh Mihidinit. U përmenden këtu edhe disa propozime për ngritje të shtatorëve të heronjve tjerë të Komunës sonë, desha ti përmend disa individë të tjerë të komunës sonë të cilët kanë kontribut për Kosovën dhe besoj meritojnë një kujtim nga Komuna jonë ndoshta jo me buste por së paku menjë pllakë përkujtimore. Lufta për çlirimin e Kosovës nuk ka filluar vetëm në vitin 1997 – 1998 por ka filluar menjëherë pas fillimit të Kosovës nga okupatori, përpjekja për çlirimin e Kosovës ka qenë në vazhdimësi. Unë e kam fjalën për veprimtarët e shumtë por në mesin e tyre unë do i ceki disa që i njoh si Halil Durguti, Shaban Durguti, Hamdi Korenica, Hasan Vuçitërna, mendoj që të gjithë këta që i përmenda dhe shumë të tjerë që unë nuk i njohë e meritojnë të kenë një pllakë përkujtimore në Rahovec në mënyrë që ta dinë edhe gjeneratat e tjera që në komunën tonë ka pas njerëz të cilët janë përpjekur dhe janë sakrifikuar që ne sot të jemi të lirë dhe ta gëzojmë këtë liri dhe pavarësi.

Fatmir Iska – Singerisht pajtohem me Kryetarin kur e tha se nuk do koment kjo punë sepse puna e tyre është shumë e madhe dhe kontributi i tyre është shumë më i madh. Ne si qytetar të Kosovës e kemi obligim për me i respektu këto figura, neve na mbetet vetëm ta vazhdojmë punën aty ku ka mbete edhe me këta dy heronj të tjerë. Këta emra që i përmendi Xhihadi ne i kemi respektuar dhe i kemi nderuar në Komisionin për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave ku disa emra të tyre ja kemi lënë rrugëve të komunës sonë, mendoj se nuk është mirë që të debatojmë se kush çka propozon sepse kjo është obligim i të gjithë qytetareve të komunës së Rahovecit.

Kryesuesi – Është mirë që të bëhet një pllakë përkujtimore në të ardhmen, mendoj se është propozimi i Xhihadit është me vend.

Rukije Krasniqi – Siç e thanë edhe kolegët e mi ne duhet të përkulemi para veprave të heronjve tanë të cilët kanë kontribuar në shtet formimin tonë. Mendoj se propozim vendimi për shtatorët e veprimtarëve fetarë a mos është duke u kërcënuar karakteri laik i shtetit të Kosovës dhe shoqërisë tonë. E thatë se është konsultuar familja por nuk morëm përgjigje rreth ngritjes së shtatores së Shejh Mihidinit prandaj

udhëheqësit shpirtërorë më tepër nuk përkojnë me parimet fetare, shpresoj që të ketë karakter ma tepër kombëtar apo fetar e jo vetëm për motive votash, kjo mendoj se do të ndikojnë në përçarjen e komuniteteve tjera fetare në komunën tonë dhe krijon president për ngritjen e shtatorëve tjerë të klerikëve tjerë fetarë.

Kryetari – Rukijë Shejh Mihidini në burg nuk ka shkuar për Teqe dhe Xhami, ai ka shkuar për çështje kombëtare dhe ai është i shpallur hero nga institucionet e shtetit dhe ne e kemi për detyrë që të ja bëjmë një shtatore.

Besnik Hoti – Përshëndetje për të gjithë, Personalisht e përkrahi propozim vendimin e Kryetarit për ngritjen e shtatores për heroin Shejh Mihidnin Shehut, është mirë që të gjithë heronjve të Kosovës ti ngritët nga një shtatore sepse ata e meritojnë.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kjo është një iniciativë shumë e mirë dhe shumë e qëlluar e Kryetarit të Komunës për ngritjen e shtatores për heroin e Kosovës Shejh Mihidinit dhe gjithë heronjve tjerë që gjinden në komunën tonë. Ne si grupe i PDK-së e mbështesim këtë propozim.

Kadri Dellova – Qëndroj fuqishëm pas shefit të grupit, liria jonë është falë sakrificave të dëshmorëve dhe martirëve të kombit. Pajtohem plotësisht me propozimin e Xhihadi që edhe atyre njerëzve që kanë sakrifikuar për atdheun dhe kombin në etapa të ndryshme të i ngritët një pllakë përkujtimore.

Selim Duraku – Ne emër të grupit të LDK-së e përkrahim propozim vendimin e Kryetarit të Komunës por jemi pro edhe propozimeve që i dha z. Florije që në të ardhmen të kemi parasysh shtatore edhe për heronj tjerë.

Bahtjar Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Për deri sa e ka titullin Hero nuk e di se pse jemi duke debatuar, propozimi është të miratohet ose jo propozimi i Kryetarit, nuk e di se pse jemi duke Debatuar për heroizmin e dikujt kur institucionet qendrore e kanë shpallur hero sigurisht duke analizuar kontributet në periudha të ndryshme.

Fatmir Iska – Edhe ne në emër të grupit të AAK-së e përkrahim propozim vendimin e Kryetarit.

Kryesuesi – E qes në votim propozim vendimin e Kryetarit për ngritjen e shtatores për heroin e Kosovës Shejh Mihidinin dhe shpalljen e një pjese të parcelës me nr.1196 si interes i përgjithsëm ku do të vendoset shtatorja: Konstatoj se në mënyrë unanime është votuar pro këtij Propozimi. Pika e radhës:

4. Shqyrtimi i Kërkesës së NTP “Vëllezërit Morina” nga Xërxa për dhënien e lejes së përkohshme për ushtrim të veprimtarisë,

Këta kërkojnë që ti jepet leje për një vit deri sa të dislokohet nga ky vend për shkak se ky vende është i shpallur si zonë e mbrojtur dhe me planifikim hapësinorë të komunës parashihet që ajo t hiqet nga zona e mbrojtur por nuk do të lejohet më të ketë kësi lloj objekte siç janë seperacionet por duhet të jenë më tepër objekte të rekreacionit dhe turizmit.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Kompania në fjalë me dt. 23.12. 2015 e ka bërë një kërkesë në drejtori për urbanizëm për marrjen e pëlqimit mjedisorë për zhvillimin e veprimtarisë të fabrikës së betonit dhe seperacionit të rërës, drejtorja e urbanizimit e ka refuzuar kërkesën për arsye se këto tre parcela 777 ,778 dhe 779 me nr. 478 zona kadastrale Xërxë Komuna e Rahovecit është zonë e mbrojtur me vendim të kuvendit komunal të vitit 1986. Në këtë raste kjo kërkesë tash i takon kuvendit komunal sepse ky trupë e ka shpallur këtë parcelë si zonë e mbrojtur. Në vendim e kemi njoftuar palën se komuna e Rahovecit është në proces të hartimit hartën zonale dhe e ka paraparë këtë zonë ta shpallë si zonë ndërtimore me destinim të caktuar, në anën e djathtë ideja është që të bëhet zonë për ndërtim duke zhvilluar turizmin ndërsa në anën e majtë zonë rekreative sportive dhe ndërtimore me kushtet dhe specifika të caktuara. Pala më herët i ka pas 9 pëlqime të përkohshme që i ka marrë nga komuna, ju kisha lutë juve që ma shumë se 1 vit mos me ja dhanë sepse brenda q viti besojmë se do të finalizohet harta zonale.

Fatmir Iska – Me qen se janë përmend edhe leje të përkohshme mjedisore që janë dhënë ma herët dhe nëse prapë nuk paraqet ndonjë problem ligjor mendoj se mirë është me e përkrah këtë vendim që ti jepet leja mjedisore komunale për 1 vit. Flas në emër të grupit të AAK-së ne jemi për ta përkrahur këtë vendim.

Selim Duraku – Edhe në emër të grupit të LDK-së jemi për vazhdimin e këtij vendimi për 1 vit deri sa të i hejë ato mjete nga kjo pronë.

Kryetari – Për këtë çështje parimisht jam i përcaktuar që nëse nuk është e lejueshme nuk duhet të ja japim, pyes Drejtorin e Urbanizmit a keni bërë konsulta shtesë me Ministrin e Urbanizmit për këtë çështje. Po ashtu dua ta di a ka pas ndonjë ndryshim në ligj gjatë kësaj periudhe.

Kryesuesi – Unë jam konsultuar me zyrtarët e zyrës ligjore më kanë than se kemi të drejtë ti japim leje mjedisore për një vite nëse është diçka e kundërligjshme MAPL-ja do na kthej si të pa bazë ose e paligjshme pastaj do të anulohet ose të rishqyrtohet ky vendim.

Bahtjar Hoti – Kriteret për marrjen e këtyre pëlqimeve edhe pse e merë në Ministrinë e Mjedisit dhe në Komision të pavarur të minierave dhe mineraleve të dy këto institucione nuk ja vazhdojnë atij lejen nëse nuk merë pëlqimin nga komuna dhe komuniteti që gjendet për rreth.

Kryesuesi – Drejtori në përgjegjësin vetë nuk e ka marrë për këtë vendim, ne kemi pas raste në të kaluarën që janë dhënë pëlqime nga drejtoritë dhe jemi detyruar pastaj si kuvend të mërimi me ato çështje, mendoj se mirë është që ky vendim po shkon përmes kuvendit dhe gjithashtu mendoj se nuk jemi duke shkelur ligjin.

Rasim Fazliu – Drejtori e tha në fillim që nga viti 1986 kjo zonë është e shpallur si zonë e mbrojtur ndërsa ky zotëri që nga pas lufta është duke ushtruar këtë veprimtari në at vend, për mua është shqetësuese që kjo veprimtari ka vazhduar punën deri më tani dhe tash ne mundë të ja japim edhe këtë vite pastaj edhe vitin tjetër e kështu me radhë, kur ne të gjithë e dimë se në zona të mbrojtura është e ndaluar të ndërtohet ose ushtrohet çfarëdo veprimtarie. Për hire të transparencës së drejtoritë ne edhe për këtë vit është mirë ta përkrahim, por duhet të precizohet në vendim që nuk ka t[ë] drejtë viteve tjera të kërkoj kesi lloj kërkesash.

Fehmi Hoxha – Edhe një herë do ju potencoj kërkesën të cilën e kanë bërë Vëllezërit Morina në Drejtorin për Urbanizëm, për shkak të pengesave ligjore sepse ajo pjesë është zonë e mbrojtur Drejtoria për Urbanizëm e ka refuzuar këtë kërkesë. Pra për zona të mbrojtura vendos kuvendi i komunës prandaj pala ju është drejtuar juve si kuvend. Prandaj edhe nëse ja jepni lejen mos ja jepni ma shumë se 1 vit.

Lirih Berisha – Unë jam i vendimit që të japim për 1 vit, ne më parë kemi dhanë me nga 15 – 20 vjet e nuk është bërë asgjë, besoj se kjo kohë i mjafton që ti bartë makineritë që i ka në atë vend.

Kryesuesi - E qesë në votim pikën e 4 të rendit të ditës: Konstatohet se me 1 kundër dhe tjerët pro është aprovuar pika e 4 e rendit të ditës që ti jepet pëlqimi për 1 vit deri sa ti bartë makineritë nga ajo pjesë.

5. Shqyrtimi i propozim vendimeve për mbrojtjen e vlerave të natyrës (10 vendime),

Kryesuesi – Përshëndesë zyrtarët e institutit për mbrojtjen e monumenteve pranë Ministrisë së MMPH që janë sot prezentë këtu me ne. Në këtë pikë përfshihen 10 vendime të cilët do ti votojmë si paket por do ti lexojmë të gjitha një nga një.

Fehmi Hoxha – Bazuar në ligjin për mbrojtjen e natyrës si dhe ligjit për vetëqeverisje lokale, komuna e Rahovecit duhet të shqyrtojë raportin e studimeve të vlerave natyrore në territorin e Komunës së Rahovecit dhe të merr një vendim për mbrojtjen e objekteve të propozuara. Instituti Kosovar për mbrojtjen e Mjedisit dhe mbrojtjen e natyrës i cili vepron në kuadër të MMPH gjatë vitit 2015 së bashku me zyrtarët komunal kanë hartuar bazën profesionale për vënien nën mbrojtje të vlerave natyrore në Komunën e Rahovecit, gjithsej janë 10 monumente natyrore të propozuara së bashku me Drejtorin e Urbanizmit dhe Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit në krye me Institutin. Kjo nuk do të thotë që do të mbesim me këtë listë nëse keni ndonjë propozim tjetër që e keni identifikuar si vlerë natyrore gjithsesi se do të zgjerohet kjo listë. Për të gjitha këto monumente janë përgatitur elaboratet profesionale nga instituti, për detaje tjera më profesionale fjalën ja kaloj zyrtarit të institutit z. Qenan Maxhunit.

Qenan Maxhuni – Zyrtar i institutit për mbrojtje të monumenteve natyrore pran MMPH, Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, Instituti i Kosovës për mbrojtjen e natyrës i cili vepron në kuadër të MMPH në bashkëpunim me zyrtarët komunal gjatë verës së vitit 2004 në kuadër të aktiviteteve të tije ka bërë njohjen dhe evidentimin e vlerave natyrore në territorin e Komunës së Rahovecit, me që raste ka evidentuar shtatë vlera natyrore që meritojnë mbrojtje ligjore. Në dhjetor të vitit 2004 i propozon Kuvendit Komunal të Rahovecit iniciativën për hartimin e arsyeshmëris profesionale për shtatë vlera natyrore, Kuvendi i Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me 6 Maj 2005 e ka miratuar këtë iniciativë dhe e ka autorizuar Institutin e Natyrës që të bëjë hartimin e arsyeshmërisë profesionale për këto vlera të natyrës. Gjatë periudhës

2014/2015 instituti në bashkëpunim me departamentin e biologjisë në kuadër të Universitetit të Prishtinës i ka rishikuar këto propozime gjatë grumbullimit të këtyre të dhënave të rëndësishme që janë marrë nga tereni dhe ka përgatitur elaboratet gjegjësisht arsyeshmëritë profesionale për marrjen nën mbrojtje të 10 vlerave të natyrës në kategorinë e monumenteve të natyrës që i takojnë kategorisë së tretë sipas Unionit Ndërkombëtar për konservimin e natyrës, këto 10 vendime janë: **1. Trungu i Frashrit** në fshatin Kaznik, **2. Trungu i Shpardhit** po ashtu në Kaznik, **3. Trungu i Dushkut** në Dabidol, **4. Trungu i Shpardhit** në Drenoc, **5. Trungu i Shpardhit 2** në Drenoc, **6. Trungu i Bungut** Në Nagavc, **7. Trungu i Qarit dhe i Vidhit** në Bratotin, **8. Trungu i Shpardhit** në Bratotin, **9. Shpella e Bali Agës** në Zatriq, **10. Shpella e Peshterit** në Zatriq. Propozimi për marrjen nën mbrojtje ligjore të këtyre monumenteve të natyrës përveç vlerave të radha natyrore siç janë madhësia, trashësia a trungjeve, vjetërsia, përmasat e kurorës etj, bazohen edhe në vlera të tjera shkencore, edukativo arsimore, estetike, turistike që i bëjnë këto monumente mjaftë atraktive edhe për vizitorët. Duke u bazuar në faktet e lartë përmendura mundë të përfundojmë se këto monumente i plotësojnë kushtet që të mirën nën mbrojtje si monumente të natyrës me karakter botanik dhe gjeomorfologjik kryesisht për qëllime të konservimit të karakteristikave specifike natyrore.

Florijs Boshnjaku – Këtë material e kemi shqyrtuar edhe në KPF ku i kam parashtruar disa pyetje pikërisht për çështje të pronës, në disa vende pronar është kuvendi komunal, në disa është shfrytëzuese Ekonomia e Pyjeve të Rahovecit, disa në pronësi publike të varrezave, por këtu e kemi një vendim ku pronar është një person privat. Dua ta di a keni pas biseda me atë pronar të asaj toke dhe si do të kompozohet vendi që do ti mirët, pra kush e merë për obligim shpronësimin. Në çdo vendim në nenin 4 shkruan se përgjegjëse është Ministria cila ministri duhet të ceket në vendim. Tek neni 6 shkruan kujdestari është i detyruar, pra kush është kujdestar në këtë moment edhe kjo duhet të ceket.

Rasim Fazliu – Dua të pyes edhe unë për nenin 6 pikërisht ato që e tha edhe Florija, dua ta di a ka bërë komuna përgatitje ose ndonjë agjende se kur duhet të shkohet të vizitohen këto monumente a do të ketë vizita ditore javore apo mujore, pastaj kush do ti mirëmbajë ato monumente. Kishte me qen mirë që këtij materiali ti bashkëngjittë një shkrim ku do të ceken agjenda.

Përparim Krasniqi – Dua ta pyes zyrtarin e institutit se a do të bëhen rrethojat përreth këtyre monumenteve ose a do të vendoset ndonjë tabelar se çfarë lloji i trungut është ai. Pastaj në nenin 6 thuhet në raste të paraqitjes së shkatërrimit të atij druri duhet të lajmërohet instituti, mendoj deri sa të lajmërohet instituti ai veç e merr drurin në shtëpi, mendoj se duhet të specifikohen ma mirë disa gjëra.

Fatmir Iska – Kjo pronë private ku gjendet ky monument ka një sipërfaqe prej 71 ari 6m², në nenin 4 të këtij vendimi thuhet punimi, lëvrimi dhe shfrytëzimi i tokës në sipërfaqen e mbrojtur, nëse e marrim sot ne këtu këtë vendim dhe nga MAPL-ja bëhet i plotfuqishëm ai zotëria nuk do të mundë të punoj aty, çka nëse në këtë vite personi në fjalë ka mbjellë ndonjë kulturë bujqësore. Po ashtu nuk jemi të informuar se a kanë biseduar zyrtarët e mjedisit me ekonomin e pyjeve duke e ditë faktin se në çdo komunë bëhet prerja e drurëve, ekonomia e pyjeve në nivel lokal në fillim të sezonit të dimrit lëshon disa leje për prerje e disa drunjëve nga personat privat, mendoj se mirë është të konsultoheni me ta dhe të identifikohen këto drunjtë që janë shpallur monumente.

Bahtjar Hoti – Kryesues këtu lexova tek rendi i ditës pika e 5 shkruan shqyrtimi i propozim vendimeve për mbrojtjen e vlerave të natyrës në kllapa 10 vendime që nënkupton 10 vlera natyrore që i kemi në komunën tonë. Këto 10 vlera mbrohen me ligjin që e ka MMPH, pra vetëm le të respektohen ligjet dhe mendoj se është më mirë të shikojmë mos kemi edhe ndonjë vlerë tjetër natyrore sepse nuk mendoj se vetëm 10 vlera i ka komuna jonë, pra respektimi i ligjit nënkupton mbrojtje të këtyre vlerave.

Rukije Krasniqi – Falënderoj Zyrtarët e Institutit që na kanë sjellë informata për një çështje kaq me rëndësi për mbrojtjen e vlerave ekologjike, mundë të themi se ka shumë vlera të larta ndikimi human në vlera ekologjike e sidomos atë negativ, vlerat ekologjike mundë të jenë vlera ekonomike, etike, estetike dhe kulturore njëkohësisht. E dimë se gjatë periudhës së para luftës dhe gjatë luftës e deri më sot jo vetëm tek ne është duke u degraduar çdo ditë e më tepër ekologjia e mjedisit por edhe në botë, prandaj kanë ngritë zërin shumë organizata të ndryshme botërore si p.sh. Unioni Ndërkombëtar për ruajtjen e natyrës, Natyra 2000, Rrjeti Emerald, kanë ardhur si rezultat për mbrojtjen e këtyre vlerave me rëndësi të madhe ekologjike. Siç thanë para folësit e mijë në Komunën tonë besoj se ka ma shumë se 10 vlera natyrore por

nga mos informimi i qytetareve se çka paraqesin këto vlera ka ardhur deri tek shkatërrimi i tyre. Mendoj se mbrojtje me anë të ligjit është pjesa më e mirë që mund ti bëhet këtyre vlerave natyrore. Kryesues në të ardhmen mendoj kishte me qenë mirë që me pas si pikë të rendit të ditës Rruajtja e mjedisit ku do të diskutoheshin shumë çështje me rendësi të cilat na duhen neve në komunën tonë si për pyllëzimin ku kemi mjaftë vende që janë shkatërruar ku paraqesin një rrezik mjaftë të madhe për mjedisin tonë.

Hysni Gashi – Pajtohem me të gjithë se ky është një vendim shumë i qëlluar, këtu është ma shumë duke u folur se çka ndalohet të veprohet ose të mbillet në hapësirën ku e mbulon ai monument. Kisha qen i interesuar që të na njoftojnë zyrtarët e institutit se çka duhet të ndërmarrim që ta ruajmë atë vlerë, p.sh para 20 viteve lisi i Nagavcit ju kanë këputur dy degë, pra pyetja ime është cilat masa duhet të ndermirren së paku forma ekzistuese të ruhet.

Besnik Hoti – Kam një propozim por nuk e a i plotëson kriteret e një monumenti të natyrës, në fshatin Kramovik në Bogë ekziston një gurë i madh që quhet Guri Shrum, nga gojëdhënat thuhet se është qindra vjet i vjetër, po ashtu në atë kurë ka emra të ndryshëm të gdhendur. Prandaj dua ta di nga zyrtaret e institutit a mundet të jetë edhe ky gurë monument i natyrës.

Kryesuesi – Ju e dëgjuat kur tha Zyrtari i institutit se në vitin 2005 me vendim të jo vetëm këto 10 monumente të natyrës janë propozuar që të jenë vlera të mbrojtura por ma tepër, për momentin janë zgjedhur vetëm këto 10 monumente, por nuk do të thotë se me kaq mbyllet ky proces.

Kadri Dellova – Më vije mirë që zyrtarët e Ministrisë dhe ne si kuvend jemi duke debatuar sot për disa vende që ne i kemi konsideruar të shenjta dhe më të vërtet janë të shenjta. Desha ti ftojë zyrtarët e institutit që të vinë në Krushe të Madhe sepse në fshatin tonë është një mal të cilin e quajmë Mali Madh ku ka drunj të vjetër qindra vjeçar.

Fehmi Hoxha - Ju falënderoj të gjithëve për diskutimin e bërë sot këtu, me të vërtet shihet se ne si komunë e Rahovecit do ecim përpara duke marrë për bazë një temë që duket shumë relaksuese por që është shumë me rëndësi të veçantë. Është shumë e vërtet që në 2005 atë që e tha edhe përfaqësuesi i MMPH që është iniciuar një proces, pra tash kanë kaluar 10 vite është mirë që këto 10 monumente të propozuara nga Instituti përkatës që të procedohen për miratim, por gjithsesi edhe këto dy propozim që u dhanë sot këtu do të identifikohen nga ana e zyrtarëve të Institutit. Fatmiri pyeti se a janë në koordinim me agjencinë e pyjeve, agjencia e pyjeve është agjenci shtetërore prandaj këta gjithsesi janë në kontakte dhe i koordinojnë punët me këtë agjenci. Sa i përket asaj se një vendim është cekur se prona është private, instituti ka zhvilluar biseda me pronarët e kësaj parcele dhe janë pajtuar që të shpallet si monument i natyrës. Sa i përket asaj se a do të ketë shenjëzime instituti në këtë raste i ka siguruar mjetet për ta bërë shenjëzimin e këtyre vlerave. Të gjitha këto monumente pas marrjes së vendimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe pas certifikimit nga ana e MAPL-së do të hynë në kuadër të projeksionit buxhetor në kuadër të planit për mirëmbajtje të hapësirave publike, komuna do i merë përsipër për ti mirëmbajtur këto monumente të natyrës, pyetja ke qka nëse dëmtohet ndonjë lisë, nëse dëmtohet ose kalbet ndonjë lisë hiqet s'kemi qka të bëjmë këto janë monumentet natyrore.

Qenan Maxhuni – Falënderoj të gjithë për interesimin dhe debatin e mirë që e keni bërë sot në këtë kuvend në lidhje me vlerat natyrore. Sa i përket asaj që u përmend puna e pronës private, ne kemi biseduar me vetë pronarin në momentin e identifikimit të këtij monumenti, ka qenë vet dëshira e tij që një objekte i tillë të futet në listën e zonave të mbrojtura. Pra fjalët e tij janë jo që kam kundër diçka por është dëshirë e imja që një pronë e imja të jetë në listën zonave të mbrojtura, ky lisë gjendet në mëgje dhe atë pjesë është deklaruar se nuk e punon, pra nuk kemi kurrfarë problemi rreth kësaj.

Florije Boshnjaku – A keni marrë deklaratë me shkrim nga pronari i asaj parcele sepse nëse mundet të del ndonjë problem dhe të thotë se nuk jam pajtuar.

Qenan Maxhuni – Me qëllim e përmenda që prej 106 monumenteve të natyrës që janë në territorin e Kosovës 40% janë në prona private dhe asnjë herë nuk ka pas shpronësim të këtyre pronave ose ndonjë problem nga pronarët e këtyre pronave. pati një pyetje se kush është kujdestar i këtyre monumenteve, komuna është ajo që i shpallë monumentet e natyrës dhe ajo duhet të kujdestë për ta, instituti bënë monitorimin e vazhdueshëm dhe nëse evidenton ndonjë nevojë për ndërhyrje ne jemi të gatshëm.sa i përket

asaj që tha njëri nga ju që ju është këputur një krah, ministria për momentin nuk ka ndonjë fonde për konservimin tyre por në të ardhmen mendohet se të gjitha lisat vjetër që janë të ketë një ndërhyrje sanitare aty ku ka nevojë.

BAhtjar Hoti - Përmbi Rahovec tek rruga e shkozës është zbuluar një vendbanim i vjetër dhe shihet që aty është bërë më parë jetë, ish drejtorin e kulturës e kemi dërguar në atë vend që të shikoj, dua ta di a hynë në kuadër të institutit tuaj apo në kuadër të institutit të monumenteve historike.

Qenan Maxhuni - Ky monument nuk hynë në kuadër të institutit tonë por hynë në kuadër të institutit të monumenteve historike, puna jonë është objektet që janë krijuar nga zoti e jo nga dora e njeriut.

Hysni Gashi - A ekziston mundësi nga ana juaj që ta caktoni se sa është i vjetër ai lisë, sepse ne kemi dëgjuar për vjetërsinë e tyre vetëm përmes gojëdhënave.

Qenan Maxhuni – Është e vërtetë se nuk janë të sakta ato shkallë të përcaktimit të vjetërsisë por është përafërsisht, në të ardhmen e afërt do të jetë një projekt i përbashkët në mes MMPH dhe MBP, ata i kanë mjetet me të cilat e përcaktojnë shkallën e vjetërsisë.

Kryesuesi – edhe një herë i falënderoj përfaqësuesit e institutit të mbrojtjes së vlerave të natyrës për sqarimet që i dhanë. I qes në votim këto 10 vendime: 1. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Qarit dhe Trungu i Vidhit në Bratotin, 2. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës Shpella e Bali Agës në Zatriq, 3. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Shpardhit në Bratotin, 4. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Bungut në Nagavc, 5. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Shpardhit në Drenoc, 6. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Shpardhit në Drenoc (2), 7. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Dushkut në Dobidol, 8. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Shpardhit në Kaznik, 9. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës Trungu i Frashrit në Kaznik, 10. Vendim për mbrojtjen e vlerës së natyrës Shpella e Peshterit Në Zatriq. Pra këto janë 10 vendime votojmë : Konstatoj se në mënyrë unanime janë aprovuar këto 10 vendime për mbrojtjen e monumenteve të vlerave natyrore të Komunës së Rahovecit.

6. Shqyrtimi i kërkesës së N:T:H: “Mowenpick” nga Rahoveci,

Këtu kemi të bëjmë me një kërkesë të një operatori ekonomik i cili operon në Parkun e Qytetit, ne me një vendim të Kuvendit i kemi falur borxhet të gjitha kompanive të vilat i kanë në shfrytëzim pronat komunale që i kanë marrë me anë të tenderit, ku i kemi liru për 20%, po ashtu para vetit e keni një tabelar ku i paraqet të gjitha obligimet dhe pagesat që i ka bërë kjo firmë. Kjo pikë është trajtuar edhe në KPF ku është kërkuar që të bisedohet me përfaqësuesit e kësaj kompanie që të bëhet një aneks kontratë që përfaqësuesi i kësaj kompanie ti merr për obligim pagesën e shpenzimeve si rrymën, ujin dhe mbeturinat, sepse sipas informatave që kanë delegatët komuna deri më tani ja ka paguar këto shpenzime, pra duam një informatë nga drejtori a është nënshkruar kjo aneks kontrata.

Avdullah Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë, Ne është dashur të përgatisim një propozim vendim por kjo kërkesë ka ardhur drejtpërdrejtë në zyrën e kryesuesit të Kuvendit, pra nuk është adresuar tek ekzekutivi. Ky është një qiramarrës i komunës i cili e ka marrë këtë lokal në park të qytetit me qira me 24 maj 213, ngarkesa e përgjithshme e këtij qiramarrësi ka qenë 4,920.00 € pagesë ka bërë 2,665.00 € dhe shuma e mbetur për pagesë deri në fund të vitit 2015 është 2,255.00 €. Ne disa biznese me vendim të këtij kuvendi i kemi liru për 20% dhe tash është vendimi i juaj se a do ta lironi edhe këtë qiramarrës. Sa i përket asaj punës së pagesës së shpenzimeve të rrymës, ujit dhe mbeturinave, qysh në fillim të mandatit tonë ne ja kemi ndërprerë dhe nuk ja kemi paguar asnjë shpenzim dhe në kontratë nuk është e precizuar që komuna të ja paguaj këto shpenzime prandaj nuk jemi të obliguar të bëjmë aneks kontratë, pra çdo qiramarrës është i obliguar në funde ti paguaj shpenzimet e bëra.

Rasim Fazliu – Propozoj që të gjitha kompanitë që operojnë në territorin e komunës së Rahovecit të cilët kanë obligime ndaj komunës të përfshihen në vendimin që e kemi marrë më parë për kompanitë e tjera sepse të gjithë duhet të jenë të barabartë.

Selim Duraku – Unë jam kundër këtij propozimi, në KPF është cekur se komuna ja ka paguar kësaj kompania prej nënshkrimit të kontratës e deri me nderimin e qeverisjes të gjitha shpenzimet e rrymës, ujit dhe mbeturinave. Kjo kompani i ka paguar qira mujore komunës 205 € ndërsa shpenzime ka bërë shumë ma

shumë, ne në KPF jemi akorduar që të bëhet një aneks kontratë ndërsa tani na del se në kontratë nuk është e cekur se kush duhet të i paguaj shpenzimet.

Fatmi Iska – Besoj se ne duhet të vendosim në bazë të asaj kërkesë siç kemi vepruar më herët në raste e tjera njëjtë duhet të veprojmë edhe në këtë rast.

Azbi Gashi – Sa i përket faljes së borxheve ne si LVV kemi qenë kundra për arsye se deri sa nuk na ofrohet ndonjë planë strategjik për bizneset të cilat nuk kanë pronësi komunale dhe si të ju ndihmohet, atëherë pse të ju ndihmohet vetëm bizneseve që kanë pronësi komunale, prandaj prapë jemi kundra.

Rexhep Oruçi – Mendoj se kërkesa e shfrytëzuesit të lokalit të parkut të qytetit mendoj se e ka ma shumë karakterin simbolik sepse me këtë falje nuk do të përfitoj aq shumë, unë jam pro asaj që mos ti bëjmë dallime në mes shfrytëzuesve të pronave publike komunale. i vetmi subjekt që operon në komunën e Rahovecit që e shfrytëzon lokalit e komunë dhe që nuk ju ka falë borxhi është ky lokal. Sa i përket atij kushtëzimi që është propozuar në KPF me një aneks kontrate, më duket se është absurde sepse në kontratën e vitit 2013 janë paraparë kushtet në bazë të cilës kanë aplikuar secili në tender, ta bëjmë tash një aneks kontratë do dalim qesharak sepse ashtu ai është duke i paguar ujin, rrymën dhe mbeturinat ne nuk kemi për çka ta kushtëzojmë. Unë jam pro asaj që ti ndihmojmë simbolikisht si gjithë të tjerët deri më tani, ne kemi falur edhe nga 40,000.00 € borxhe në këtë kuvend, pra mos të bëhemi cikërrimtar mos ti ndajmë bizneset.

Kryesuesi – Unë jam që ti falen edhe këtij biznesi or nuk jam për atë që të bëhen kishe nuk jemi duke e ditur se edhe këtij ju është falur sepse 1 vit komuna ja ka paguar rrymën, ujin dhe mbeturinat. Pyetje tjetër është çka kur nesër skadon kontrata dhe ky biznes na paditë sepse kontrata është shumë e pa qartë dhe jam i bindur për deri sa nuk është duke e nënshkruar këtë aneks ai do të bëjë këtë veprim. Pra ai duhet në formë të shkruar të ja bashkëngjis kontratës që nuk kërkoj që komuna të mi paguaj shpenzime nga uji, rryma dhe mbeturinat.

Lulzim Sylejmani – Ne së bashku me drejtorin e ekonomisë operatorit në fjalë ja kemi shpjeguar, prandaj mos e politizoni pagesën e rrymës me qira, qiranë ja keni falë të gjithëve falna edhe këtij. Ne e kemi ftuar operatorin dhe i kemi than që nga ky moment komuna nuk do ti paguaj rrymën, ujin dhe mbeturinat e këtij lokali, por operatori nuk ka qenë i gatshëm ta qesë një nënshkrim që do ti merë përsipër këto shpenzime edhe pse është duke i paguar. A mundet të ndodhë ajo që thotë kryesuesi unë nuk e di atë e dini ju.

Kadri Dellova – Jam duke parë se këtu një zëri jemi të gjithë për ti falur edhe kësaj kompani si i kemi falur kompanitë e tjera edhe pse kemi me pas ende kërkesa për falje të borxhit. Pajtohem me ju pra ose ne si kuvend ta bëjmë një deklaratë shtesë që ai ti merë përsipër shërbimet publike ose nëse ja lejon ligji le ta bënë drejtori e ekonomisë, pra dikush duhet të merë përsipër të bëjë këtë dokument.

Fatmir Iska – Pika është shumë e qartë për falje të borxhit, pra ne jemi këtu për me vendos a me i falë edhe këtij borxhi si gjithë të tjerëve, e jo sot këtu të diskutohet për kontrata dhe në momentin kur është lidhë kjo kontratë është ligje për të dyja palët, çka është duke u precizuar është shumë qartë në funde të kontratës. Ne para një viti kemi falë koça borxhe të hatashme e ndërsa këtij i bije që ti falim shumë pak. Ne sot këtu duhet të vendosim se në çfarë mase të përqindjes duhet të shkojmë.

Avdullah Kryeziu – Po ju ceki dispozitat përfundimtare të kësaj kontrate, neni 23 thotë: Kjo kontratë mbi dhënien në shfrytëzim të kafenesë në parkun e qytetit në Rahovec është në marrëveshje në mes dhënësit dhe marrësit dhe çdo gj që nuk është e përfshirë në këtë kontratë nuk konsiderohet pjesë e saj.

Hysni Gashi – Në këto pak seanca sa kam marrë pjesë po thuajse në çdo të dytën seancë është diskutuar për falje të borxheve, e kam një propozim pak qesharak që në mesin e pikave të rregullta edhe faljen e borxheve. Unë mundem ta votoj këtë kërkesë nëse më premtoni se nuk do të ketë më kërkesa për falje të borxheve përndryshe nëse jo unë nuk do votoj pro këtij vendimi.

Florije Boshnjaku – Edhe unë pajtohem si parafolësit që duhet të ja falim borxhin dhe po ashtu ne nuk mundemi me e kushtëzu këtë operator përderisa nuk i kemi kushtëzuar operatorët e tjerë. Ne kemi marrë një vendim këtu dhe i kemi kushtëzuar që brenda 3 muajve me i pagu borxhin por nuk i kanë paguar dhe asnjëherë nuk kemi marrë masa për mbylljen e këtyre lokaleve.

Kryesuesi – Ne gjitha kompanive që kanë marrë pronat komunale me tender i kemi falur borxhin 20%, a pajtoheni që 20% nga vlera e borxhit total të i falet kësaj kompanie dhe borxhi i mbetur të paguhet me afat kohorë deri në 6 muaj nga dita e marrjes së vendimit. E qesë në votim: Konstatoj se me 2 kundra dhe 5

abstenime të tjerët pro është aprovuar kërkesa për falje të borxhit kompanisë N:T:H: “Mowenpick” nga Rahoveci. Kalojmë në pikën e radhës:

7. Shqyrtimi i kërkesave të klubeve sportive për ndihmë financiare,

E kemi para vete një propozim vendim nga Drejtori i Kulturës, kisha kërkuar nga ju meqenëse kemi shumë pak mjete nga subvencionet në Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që ta aprovonë këtë propozim vendim ndërsa aty ku ka mungesë nëse mundemi do i mbulojmë me rishikim të buxhetit.

Xhihad Vuqitërna – Këtu e kemi para vete një listë për shpërndarje të mjeteve për ndihmë klubeve sportive dhe shoqatave kulturore. Është edhe një klube i cili e ka bërë kërkesën por nuk jam duke e parë në këtë listë e kam fjalën për Klubin Automobilistik Rahoveci i cili vepron që disa vite dhe merr pjesë në gara brenda Kosovës dhe brenda Kosovës, deri më sot gjitha shpenzimet i marrin për sipër vet pra vetë sponsorizohet, mendoj se një pjesë të mjeteve ti ndajmë këtij auto klubi. Federata e automobilistike e Kosovës është e pranuar në federatën botërore të automobilizmit, këta djelmosha garojnë dhe marrin pikë kudo që garojnë. Po ashtu mendoj se KB Rahoveci meriton ma shumë se sa që është paraparë në këtë listë, ky klube i ka rezultatet shumë të mira nuk ka asnjë humbje dhe është me projeksion që të hyjë në super ligën e Kosovës në sezonin e ardhshëm, mendoj që së paku edhe 50\$% të shumës së propozuar të ja shtojmë KB Rahoveci.

Selim Duraku – Në konsultim me grupi kemi arritur deri tek ky propozim: KF Rahoveci ti ndahen 12.000 €, ndërsa 2.000 € që i heqim nga KF Rahoveci 1.000 € të shkojnë për KB Rahoveci dhe 1.000 € sh.k.a Bajram Curri të Krushës së Madhe.

Përparim Krasniqi - Më sa po shohë unë disa kërkesa nga klubet që kanë ardhur nuk janë specifikuar në këtë listë si p.sh. SH.F Burimi nga Apterusha ka bërë kërkesë dhe nuk është në listë, kjo shkollë është në ligën rajonale të Prizrenit dhe është e licencuar.

Florijs Boshnjaku – Pyetje ime është a janë vetëm 28.000 € subvencione në Drejtorin e Kulturës apo ka edhe mjete të tjera, pyetje tjetër është në bazë të cilave kriterë është bazuar për ndarjen e këtyre mjeteve këtyre klubeve, a ka ndonjë specifikacion se për çka kanë me i shpenzua. Mendoj se duhet të mirëtohet një kriter, p.sh po nisem prej KF 18 Korrikut të Fortesës ku është bazuar që i ka ndarë 2.000 € unë propozoj që së paku 3.000 €, KF nga Ratkoci edhe këtij 3.000 €, KB dhe shoqëria kulturo artistike Bajram Curri nga Krusha e Mashe 3.000 €.

Besnik Hoti – Desha të ndalem tek KF Ratkoci është një klube i riformuar në vitin 2015, ky klube ka shumë vështirësi në financim dhe në zhvillim të mëtutjeshëm të garave e vetmja shpresë e këtij klubi janë bashkëvendësit tanë që gjinden jashtë të cilët e ndihmojnë aq sa munden. Propozoj që KF Ratkocit ti ndahet shuma prej 4.000 € qoftë edhe me rishikim të buxhetit.

Rasim Fazliu - Mendoj se këto shuma që janë paraparë nga Drejtori i Kulturës janë simbolike por duhet të dimë se kaq ka mundësi komuna. Propozoj që para se ti marrin këto mjete këta klube dhe këto shoqata të sjellin raportin e shpenzimeve paraprake, pra duhet të kushtëzohen ata të cilët nuk e sjellin raportin mos të ju lëshohen mjetet e reja.

Azbi Gashi – Pajtohem plotësisht me Florijen kur e tha se në bazë të cilave kriterë janë ndarë këto shuma, po ashtu jam që të i ritet shuma KF 18 Korriku dhe KF Ratkoci në 3.000 €.

Kryesuesi – Si jeni ju duke propozuar duhet të kemi edhe 30.000 € të tjera dhe prapë nuk mendoj se do ti mbulojmë këto propozime. Drejtori e ka bërë ndarjen përafërsisht si është bërë ndarje vitin e kaluar.

Nënkryetari – Jo kjo përbërje e Kuvendit por ai i kaluar ka aprovuar një rregullore për ndarjen e subvencioneve dhe aty i kemi gjërat e precizuara shumë qartë dhe aty janë disa kushte se si duhet dhe kujt duhet ti ndahen subvencionet. Pastaj është një komision që jepe propozim por gjithmonë duke u bazuar në rregullore, drejtori e ka sjellë një vendim që e ka propozu komisioni për kuvend për ta aprovuar.

Afrim Limani – Edhe unë pajtohem dhe jam pro asaj që ti ndihmohet këtyre klubeve sportive dhe Shoqërive kulturo artistike mirëpo paraprakisht në këtu e kemi edhe një kërkesë, kisha kërkuar nga Drejtori që çdo kërkesë të specifikohet dhe të ketë një projekt plan të vetin se për çka i nevojiten atyre mjetet, p.sh KF Rahoveci e cekë pagesa e referëve, për shujtë e shumë faktorë të tjerë, pra me anë të kësaj arsyetohet kërkesën që e ka bërë.

Hysni Gashi – Jam i bindur se të gjitha ato shoqata dhe klube që kanë aplikuar për subvencione mendoj se nuk ishin trajtuar pa qenë kërkesa e tyre valide. Gjërat janë shumë të thjeshta ne kemi buxhet 28.000 € nëse propozojmë që ti shtohet ndonjë klubi ose shoqate duhet të propozoj se kujt duhet ti hiqen.

Rasim Fazliu – Mendoj që ne të gjithë e kemi dëshirën e madhe për ti ndihmuar të gjithëve por mundësitë janë këto që janë pra në dispozicion i kemi 28.000 €, mendoj se drejtori me kryetarin dhe me anëtarët e komisionit janë konsultuar, propozoj në emër të grupit të PDK-së që të shkojmë me propozimin e dhëna nga Drejtoria e Kulturës.

Fatmir Iska – Këtu nuk është aspak faji i Drejtorit sepse këto janë mundësitë, por fajet i kanë Kryetarët e të gjitha partive që në fillim premtojnë shumë e pastaj ballafaqohen drejtorët me këto probleme. Pe marrë një shembull KF Rahoveci kërkesat këtij klubi minimale për pagesat e referave të fushave, dhe udhëtimit që i duhen janë 21,400.00 €, pra kjo shumë e propozuar nuk i përmbushë as minimumin e kërkesave të tyre. Pastaj e kemi KB Rahoveci që pretendon të hyjë në super ligë paramendoni se çfarë shpenzimi kanë ata vetëm për një lojtar e ku janë referat dhe halla e sporteve, shuma që është propozuar për KB është qesharake por prapë e them këto janë mundësitë dhe sipas mundësive këto 28.000 € duhet të shpërndahen për të gjithë. Propozimi imë është që KB Rahoveci dhe KF Rahoveci të mos i hiqen asnjë centë së paku le ti mbetet kjo shumë që është propozuar nga ana e drejtorisë.

Gardalin Shtavica – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne si drejtori jemi më së shumti të dëmtuar sepse kemi një shumë të mjeteve shumë të vogël në dispozicion për ndarjen e subvencioneve ndërsa kërkesat kanë qenë shumë të mëdha mbi 100,000.00 €, ne jemi munduar që të bëjmë një ndarje sa ma racionale për të gjitha klubet sportive, OJQ dhe shoqatave rinore. Njëra prej arsyeve se pse KF Rahoveci i kemi ndarë shumën prej 14,000.00 € është sepse KF Rahoveci ka një traditë prej 85 viteve, klubi po ashtu rrezikohet që të largohet nga liga e par, ky klube për këtë sezon ka bërë disa transfere dhe presim që të korë rezultate. KF Rahoveci ka bërë një marrëveshje me shollën e futbollit Rahovera ku për këtë vite janë inkuadruar 5 lojtar të kësaj shkollë dhe presim që në të ardhmen ky klube të merë sa ma shumë lojtar nga kjo shkollë. Shoqëria artistike Bajram Curri vitin e kaluar e ka pas 40 vjetorin ku ka marrë një subvencion prej 5.000 € nga drejtoria e kulturës, ku 2.000 € i kanë shpenzuar për mbrëmjet e 40 vjetorit, besoj se 2.500 € mjaftojnë për këtë vite. Mendoj se më tepër të dëmtuar janë shoqëria Kulturo artistike Rahoveci dhe Anadrinia sepse atyre ju është ndarë shuma prej 1.000 €. Përveç shkollës së futbollit të Apterushës nuk është përfshi edhe shkolla e Futbollit Rahovera dhe Dardania në ndarjen e subvencioneve jo pse nuk kemi pas dëshirë ti i ndajmë mjete por nga pamundësia.

Hysni Gashi – Këto Klube dhe shoqata a i kanë sjellë në drejtori raportet e shpenzimeve të mjeteve nga viti i kaluar, jam pro asaj që ata qll nuk e kanë sjellë raportin e shpenzimeve mos të i lëshohet asnjë cent.

Gardalin Shtavica - Të gjitha klubet dhe OJQ i kanë sjellë raportet e shpenzimeve të vitit të kaluar.

Kryesuesi – Pra na ka mbetur që ti përfshimë vetëm shkollën e futbollit Burimi të Apterushës, shkollën e futbollit Rahovera të Rahovecit dhe Klubi Dardania e Hoçës së Vogël, pra kishte me qenë mirë 1.000 € shkollës së futbollit Burimi, 1.000 € shkollës së futbollit Rahovera dhe 500 € shkollës së futbollit Dardania të Hoçës së Vogël. Por duhet të i heqim të gjithëve nga pak në mënyrë që ti paguajmë edhe këto shkolla të futbollit, a jeni të pajtimit me këtë propozim nëse po e qes në votim: Konstatohet se me 2 abstenime dhe 1 kundër aprovohet propozim vendimi për ndarjen e subvencioneve me një kushte që të gjitha klubet të cilat përfitojnë nga subvencionet të sjellin raporte financiare për shpenzimet që i bëjnë.

8. Rishqyrtimi i vendimit 130.01 të dt. 09.12.2015 i Kedsit,

Këtu kemi të bëjmë me një vendim të cilin e kemi marrë në muajin dhjetor lidhur me lejimin e disa pagesave nga disa taksa komunale kompaninë e Kedsit, mirëpo komisioni ndërqeveritar e ka kthyer këtë vendim sepse nuk është në harmoni me ligjin mbi ndërtimet të nenit 21 paragrafi 3 të ligjit mbi ndërtim. Ky vendim ka ardhë me vonesë dhe brenda 30 ditëve duhet të shqyrtohet ky vendim nëse jeni të pajtimit që zyra ligjore me e përgatit këtë vendim dhe me ja dërgu MAPL-së.

Nënkryetari – Nuk kemi të bëjmë me rishqyrtim, ky kuvend ka marrë një vendim i cili e ka aprovuar pjesërisht kërkesën e Kedsit për shtrirjen dhe investimet në ngritjen e shtyllave të reja të betonit dhe futjen e rrjetit nëntokësor nën tok, sekretaria e kuvendit gabimisht e ka cek në vendim lejen ndërtimore për investime brenda asaj, ne këtu nuk kemi të bëjmë me leje ndërtimore dhe investime kapitale. Ky vendim

duhet të përmisohet sepse MAPL-ja së bashku me MAPH kanë thanë se ky vendim për ne është i paqartë dhe duhet të qartësohet ky vendim. Zyra ligjore e ka marrë përsipër për me rregullu dhe ta bëjë në suaza të ligjeve që janë në fuqi.

Fehim Fetoshi – Esenca është vetëm tek shkrimi ose përpilimi i vendimit, nga ju kërkohet vetëm një autorizim për zyrën ligjore që ta ndryshojë vetëm formulimin e këtij vendimi.

Kryesuesi - Këtë pikë e lëmë për seancën e radhës të Kuvendit Komunal. Kalojmë në pikën e radhës:

9. Propozim vendimi për kompensimin e dëmeve të Nikë Martin Uka nga fshati Doblibare – Gjakovë, Edhe ky propozim vendim ka ardhur me vonesë, po ashtu nuk jam i informuar sa duhet rreth kësaj çështje për ma shumë informata fjalën e ka Nënkrjetari i Komunës.

Nënkrjetari – Shumica nga ju e dini projekti për furnizimin e pesë fshatrave të anadrenis me ujë të pijes ka qenë një projekt i vitit 2009 dhe ka filluar diku në vitin 2010. Ky projekt ka kaluar nëpër pronat publike dhe pronat private dhe një ndër pronat private që ka kaluar është edhe në pronat e Nikë Martin Uka nga Doblibare të cilit ju ka dëmtuar mali, ky person në vitin 2012 ka kërkuar me një kërkesë të veçantë që ti kompensohet dëmi. Vlerësimi është bërë por kompensimi nuk është bërë. Prandaj kërkohet nga kuvendi që të jepe një dritë të gjelbër që në bazë të procesverbalit të komisionit komunal për vlerësimin e dëmit është përcaktuar vlera diku 1,880.00 € dhe në bazë të vendimit të kuvendit palës të i paguhet ky dëmshpërblim nga ana e Drejtorisë së Financave. Nëse nuk i paguajmë kemi kërcënime nga pala se do të merë veprime ndaj komunës për të cilat ai mendojnë se janë të ligjshme për të. Mundeni të thoni se a e ka marrë Radoniqi në menaxhim është e vërtetë por Komuna e Rahovecit është financuese Kryesore e projektit së bashku me Qeverinë Qendrore të Kosovës në lidhje me implementimin e këtij projekti, ne si komunë e kemi për obligim që ti kompensojmë palët të cilët dëmtohen.

Flori Boshnjaku – Mu nuk është duke më dëmtuar nëse ja kemi dëmtuar pronën ne duhet të ja kompensojmë, dua ta di a ka edhe ndonjë dëm tjetër të shkaktuar nga ky projekt sepse mundë të dëgjojnë palët e tjera dhe vëna na paraqesin kërkesë për kompensim dhe ne duhet nën stop të merremi me këto lloj kërkesa, po ashtu mendoj se është ngarkesë për buxhetin e komunës.

Sinan Bajraktari – Jam i njoftuar me pronën e z. Nikë Uka nga fshati Doblibare, vendi ku ju është dëmtuar prona e tije quhet Lugu i Butë, prona e tije është e tipit gjetherënëse që quhet Dushkë, kjo pronë është e dëmtuar përafërsisht diku 600 m gjatësi dhe gjerësi 4 m, kjo sipërfaqe e këtij zotëriu ju është shpronësuar sepse ka pas me kaluar gypi i ujit të pijes, në atë përdhë ne dija persona në emër të bashkësisë lokale në vitin 2009/2010 ku kemi kontaktuar me këtë person së paku 10 herë. Ky person ka qenë penguesi kryesor i këtij projekti sepse nuk ka lejuar të kaloj gypi nëpër këtë parcelë, sipas këtij personi prona ku bëhet shpronësimi duhet të paguhet. Jam duke parë se komuna e ka autorizuar një komision por nuk është duke më pëlqyer sepse është rritur kostoja, me profesion jam biolog dhe nuk ka pyje që për 10 vite kalojnë masën 3.5 m. Unë jam për me ja kompensuar rastin por ne 2 fshatrat në mesin e këtyre 5 fshatrave ende nuk kemi ujë të pijes, javën e kaluar kemi qenë në Radoniq dhe ata thonë se këtë çështje e ka Komuna e Rahovecit jo ne ndërsa në komunë thonë se i ka Radoniqi pra ne për një defekt të vogël që është në Guri të Kuq kemi mbetur pa ujë.

Nënkrjetari – Ai që e ka qitë nënshkrimin ka edhe përgjegjësi, Radoniqi ju ka thanë shumë bukur investitori i projektit nuk ka qenë Radoniqi, kompania e Radoniqit është administrues i projektit në momentin e dorëzimit të projektit, investues kryesor është Komuna e Rahovecit së bashku me Qeverinë e Kosovës. A ka qenë ai dru i gjatë apo jo nuk e di por ai dru më nuk është aty nuk ekziston, pra në këtë pronë gjithmonë ka me pas qasje Radoniqi për sanimin e ndonjë defekti, në atë pronë nuk mundet asgjë më të mbillet.

Selim Duraku – Pajtohem me sinanin, dua ta di se pse është cekur 42 €m³ kur e dimë se atë vite kanë kushtuar 35 €m³.

Bahtjar Hoti – Kjo punë e ka një zgjidhje në momentin e kyçjes komplet ajo pronë kalon në pronësi të Radoniqit sepse Radoniqi i mbledhë taksat, a e lejon apo jo Nik Uka neve nuk na intereson fare sepse ai e ka përgjegjësin e mirëmbajtjes. Me këtë hapen dyer që ti vinë qytetarët e tjerë të kërkojnë kompensim.

Qazim Qeska – Detyra e Komunës është paraprakisht me e bo eksproprijimin nëse donë me kalu, sapo mora vesh se kjo pronë është në territor të Gjakovës, atëherë eksproprijimin është dashur ta bëjë Komuna e

Gjakovës. Pe marrë një shembull? Traseja e lartë përçuesit që i ka kaluar vetëm në ajër janë duke i nxjerrë me gjyq nga 2.500 €, pra edhe kjo duhet të i paguhet zotërisë sepse ai është dëmtuar. Rreth asaj se a kërkojnë t tjerët nëse kërkojnë të gjithëve duhet të i paguajmë sepse nëse i refuzojmë ata shkojnë në gjykatë dhe mbas ligjit mbi detyrimet do të fitoj në gjyq.

Përparim Krasniqi – Sa jam duke parë unë këtu nuk bëhet fjalë për shpronësim të tokës por zotëria po kërkon pagesë për dëmet e shkaktuara, që nga viti 2009 ai person ma shumë ka shpenzuar naftë për të ardhur në Rahovec se sa që do të fitoj për dëmet e shkaktuar. Unë jam që ti ja paguajmë sepse nuk është vlerë e madhe.

Kryesuesi – E qesë në votim Propozim Vendimin për pagesë të dëmit: Konstatoj se me 4 kundra dhe 1 abstenim dhe të tjerët pro është aprovuar vendimi për pagesën e dëmit shkaktuar z. Nik Ukës.

10. Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e Këshilltarëve.

Kishte me qenë ma mirë që në mënyrë elektronike ti dërgoni pyetjet dhe përgjigjet do i merrni me kohë.

Elvedina Cana – Sa i përket çështjes së autobusëve që janë përmendur ma herët desha ta japë një propozim, p.sh pse komuna e Rahovecit nuk po i bënë busat lokal me linjat brenda komunës së Rahovecit në mënyrë që të bëhet transportimi i nxënësve të shkollave, të gjithë e dimë se busat lokalë e kanë çmimin ma të ulët dhe ky çmim i kishte konvencuar edhe nxënësve.

Besnik Hoti – Kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike? me intereson me e ditë se komuna jona a ka ndonjë kompani të kontraktuar e cila mirët me mirëmbajtje të ndriçimit publik, nëse ka pse nuk vinë në Ratkoc unë disa herë kam bërë ankesë rreth dëmtimit të ndriçimit publik, prandaj ju kisha lutë nëse ka kompani të kontraktuar që të vinë në fshatin Ratkoc dhe të ta rregullojnë këtë ndriçim.

Azbi Gashi – Kam një pyetje për Drejtorin e Ekonomisë ? Pasi që çdo mbledhje na vijnë kërkesat për falje të borxheve për ata që i kanë lokalet e komunës, pyetja ime është a keni ndonjë planë ose ndonjë lehtësim për ti dalë në ndihmë atyre të cilët nuk kanë lokalet ose pronat e komunës me qira. Pyetje tjetër është për Kryesuesin, kam qenë anëtar në dy komisione, komisionin për emërtimin e rrugëve dhe komisionin për vend xhahishte që të dy komisionet e kanë kryer punën e vetë ndërsa unë për asnjë komision nuk jam paguar, dua ta di se ku është problemi.

Sinan Bajraktari – Pyetja ime është për Drejtorin e Shërbimeve Publike a do të asfaltohet sivjet rruga Pastasel – Kaznik. Ndërsa pyetja e dytë është rreth ujit të pijes për dy fshatra Palluzhë dhe Guri të Kuq a ka shpresë që këto dy fshatra të kenë ujë të pijes këtë vit.

Florida Krasniqi – Kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike,? Personat të cilët marrin leje për prerje të asfaltit në shumë raste e prejnë asfaltin dhe e lëna ashtu nuk e rregullojnë ose nuk e mbulojnë por e lëna ashtu, këtë punë a duhet ta kryen ata apo drejtorja.

Flori Boshnjaku – Kam disa pyetje për Drejtorin e Shëndetësisë, e pashë në projekt Dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi, kisha kërkuar që mundësisht të bëhet edhe deratizimi nëpër objekte kolektive sepse kanë nisur të shumohen. Pyetja tjetër është a ka mundësi që të qëndrojnë edhe një mjekë në kujdestari.

Selim Duraku – Unë ende nuk kam marrë përgjigje për pyetjet në dy seancave të mëparshme që i kam bërë. Pra pse të lodhem të bëjë pyetje prapë kur nuk marrë përgjigje.

Nënkryetari – Qështja e ujit të pijes për dy fshatra Polluzhë dhe Guri i Kuq ne kemi premtime të forta sepse CDIIA një shoqatë i ka dhënë mjete për riparimin e rrjetit, sipas tyre më së largu deri në muajin Qershor do të lëshohen.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 16:00

Procesmbajtësi
Skender Hamza

K R Y E S U E S I
Nahit Elshani